

Ne fokus/ Gati surpriza kuqezi per Adnan Januzajn

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 25 Nentor 2013 21:10



Ne daten 7 dhjetor ne "Old Trafford" do te jene disa tifoze special. Nisma per te bindur Adnan Januzaj ti thote po Shqiperise tani do te kaloj ne nje tjetër hap. Disa shqiptare qe jetojne ne Angli kane menduar ti bejne nje surprize lojtarit qe luan per Manchester United. Ne ndeshjen qe kjo skuader do te luaj me Newcastle do te jene te shumte ne stadium dhe do te shpalosin disa pankarta per te bindur shqiptarin ti thote po kuqezinjve. "Te nderuar shqiptare, me 7 dhjetor 2013 zhvillohet ndeshja Manchester United – Newcastle, me kete rast kemi organizuar te japim nje mesazh nga stadiumi "Old Trafford". Ju lusim te gjithë shqiptaret qe keni mundesi t'i bashkoheni aksionit qe te behet sa me madheshtor. Parulla do te hapet ne "Entrance nr.43 Block N1404". Per vendin dhe oren e grumbullimit te pjesemarrësve do te njoftoheni ne ditet ne vijim", shkruhej ne njoftimin ne "facebook".